



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit**  
**Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit**

Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**PËR**

**VENDIMIN**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË FIER, ME KANDIDATIN**  
**NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALDEMOKRATE”, ZJ. KEJDI**  
**ALFRED RESULI**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Me shkresën nr. 8452 prot., datë 20.8.2024, Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, zj. Arbësa Misir Musabelliu, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, 1and 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, për Këshillin e Bashkisë Fier, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 6, zj. Kejdi Alfred Resuli.

Me shkresën nr. 2581, prot., datë 4.9.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, zj. Kejdi Alfred Resuli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Socialdemokrate” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër FR-PSD-4996\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Kejdi Alfred Resuli rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, me shkresën nr. 2715 prot., datë 16.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 2714 prot., datë 16.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Kejdi Alfred Resuli.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Kejdi Alfred Resuli, në Këshillin e Bashkisë Fier.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 14693/1 prot., datë 20.9.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Kejdi Alfred Resuli, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Kejdi Alfred Resuli, në Këshillin e Bashkisë Fier, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

<b>Pavlina DOÇAJ</b>	-Shef i Sektorit të Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit
<b>Jona JOSIFI</b>	-Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
<b>Madalena KOJA</b>	-Drejtoria e Ligjshmërisë
<b>Majlinda ÇELMETA</b>	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË FIER, ME KANDIDATIN  
NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", ZJ. KEJDI  
ALFRED RESULI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 8452 prot., datë 20.8.2024, Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, zj. Arbësa Misir Musabelliu, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate".

Në mbështetje të nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", për Këshillin e Bashkisë Fier, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 6, zj. Kejdi Alfred Resuli.

Me shkresën nr. 2581, prot., datë 4.9.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, zj. Kejdi Alfred Resuli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: .2024 Nr: 123456  
Ora:



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", zj. Kejdi Alfred Resuli".

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Socialdemokrate” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër FR-PSD-4996\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Kejdi Alfred Resuli, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, me shkresën nr. 2715 prot., datë 16.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 2714 prot., datë 16.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Kejdi Alfred Resuli.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Kejdi Alfred Resuli, në Këshillin e Bashkisë Fier.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 14693/1 prot., datë 20.9.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Kejdi Alfred Resuli, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Kejdi Alfred Resuli, në Këshillin e Bashkisë Fier, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, zj. Kejdi Alfred Resuli.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**